



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 484, datë 20.10.2020

### PËR SHPALLJEN E POZICIONEVE TË LIRA PËR GJYQTARËT E EMËRUAR MË DATË 20.10.2020, TË DIPLOMUAR NË PËRFUNDIM TË PROGRAMIT TREVJEÇAR TË FORMIMIT FILLESTAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020 dhe pozicionet e lira në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

### VENDOSI:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.
2. Pozicionet e lira janë si mëposhtë:
  - a) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
  - b) **dy** pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
  - c) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
  - ç) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
  - d) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
  - dh) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
  - e) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat;
  - ë) **dy** pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet;
  - f) **dy** pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
  - g) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.
2. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. Të emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Afati i aplikimit është deri më datë 23.10.2020. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.
6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:
  - a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.
  - b) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## SHTOJCË

### VETËDEKLARIM

#### PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (*emër, atësia, mbiemri*), i emëruar me Vendimin nr.\_\_\_\_, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 8, pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

#### DEKLAROJ SE:

**Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale**, sipas nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastin e caktimit në një prej gjykatave të shkallës së parë të shpallura me Vendimin nr.484, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lëshuar më \_\_\_\_10.2020

#### DEKLARUESI

---

(*Emri, atësia, mbiemri*)  
(*Nënshkrimi*)

## VETËDEKLARIM

### PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (emër, atësia, mbiemri), i emëruar me Vendimin nr.\_\_\_\_, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 8, pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

#### DEKLAROJ SE:

**Do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale**, sipas nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rast të caktimit në këto gjykata të shkallës së parë të shpallura me Vendimin nr.484, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor** \_\_\_\_\_ (Berat / Korçë / Kavajë / Kurbin / Lushnjë / Mat / Përmet / Sarandë / Tropojë), për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorisë pranë kësaj Gjykate / me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Gjykatën Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.
2. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor** \_\_\_\_\_ (Fier), **Seksioni Civil**, për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Seksionin Civil të Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.
3. **Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor** \_\_\_\_\_ (Fier), **Seksioni Penal**, për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Seksionin Penal të Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.

Lëshuar më \_\_\_\_ .10.2020

#### DEKLARUESI

\_\_\_\_\_  
(Emri, atësia, mbiemri)  
(Nënshkrimi)